

## KUJTESË

Për të realizuar provimin në disiplinën: “Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njërive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës” datë 28.09.2024 kandidatëve do t’u jepen:

- Testi i provimit;
- Një fletore;
- Një stilolaps.

Kandidatët duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit, makinën llogaritëse.

Materialet që i lejohen kandidatit në tavolinën e provimit gjatë zhvillimit të provimit janë:

1. Dokument identifikimi;
2. Laps, stilolaps, vizore, fshirëse;
3. Makinë llogaritëse të thjeshtë;
4. Ujë;
5. Stilolaps blu për dhënien e zgjidhjeve përfundimtare të testit.

Çdo kandidati do t’i jepen dy zarfa – një zarf i madh dhe një zarf i vogël, dhe një fletë ku do të shënohet emri, mbiemri dhe numri i kartës ID i cili do të futet në zarfin e vogël nga grupi i verifikimit dhe sekretimit në momentin e verifikimit të identitetit të kandidatit.

Zarfi i madh do të përdoret në përfundim të testimit për të futur zarfin e vogël, fletoren e provimit me zgjidhjet e testit.

### **Kujdes!**

- Kandidatët nuk duhet në asnjë mënyrë të shkruajnë emrin e tyre në fletore dhe as në fletët e tezës.
- Kandidatët duhet të japin përgjigjet e tyre **vetëm në fletore, çdo shënim do të bëhet vetëm tek testi, i cili nuk do të jetë pjesë e sekretimit.** Çdo shënim i tepërt në fletore do të jetë skualifikues.
- Zgjidhja e çdo ushtrimi duhet të jepet në faqe të re, përveç ushtrimeve me alternativë dhe e vërtetë e gabuar.
- Në fletore duhet të tregohet qartë në krye të faqes numri i ushtrimit/pyetjes për të cilin jepet zgjidhja dhe nëse numrat e ushtrimeve/pyetjeve nuk do të jenë progresiv por do të përsëriten për seksione të ndryshme që mund të jetë ndarë testi, atëherë në fletore duhet të shënohet emërtimi i seksionit dhe numri i ushtrimit për të cilin jepet

zgjidhja. Zgjidhja duhet të jepet në vijueshmëri në faqet e fletëve të fletores (pra nuk duhet lënë faqe bosh).

- Në rast kur kandidati gjatë përgjigjes kërkon të bëjë një korigjim të një përgjigjeje të dhënë, fjala ose shprehja duhet të futet në kllapa dhe t'i kalohet një vijë sipër sipas këtij modeli: (~~standardet ndërkombëtare~~);
- Pas shpërndarjes së testit, kandidati nuk i lejohet të dalë nga salla e provimit deri në përfundim të kohës së provimit; dhe atëherë vetëm pasi vëzhguesit e provimit të kenë mbledhur të gjitha testet dhe zarfet e vegjël nga tavolinat e kandidatëve dhe të japin udhëzimin për tu larguar.
- Nëse kandidati do të kërkojë të dalë për një kohë të shkurtër nga salla e provimit, ai do të shoqërohet nga një prej vëzhguesve të sallës së provimit.
- **Zarfi i vogël do të mbahet i hapur dhe do të mbyllet vetëm nga grupi i verifikimit dhe sekretimit.**
- Zarfi i madh do të mbyllet në përfundim të testimit pasi të jetë futur në të zarfi i vogël dhe fletorja e provimit, nga vëzhguesit e sallës në prezencë të kandidatit.
- Celularët do të futen në çanta dhe së bashku me to do të vendosen në kreun e sallës. Celularët nuk duhet të jenë në gjendje pune.
- Nuk lejohet të përdoret asnjë shenjë që do të shërbente për të identifikuar fletoren.

**Në rast të konstatimit të një shenje si më sipër, personi do të skualifikohet nga provimi në momentin e sekretimit.**

Ndalohet komunikimi i kandidatëve me njëri-tjetrin gjatë provimit. Në qoftë se një gjë e tillë ndodh, atëherë vëzhguesit e provimit janë të detyruar të njoftojnë KPAP.

Në përfundim të kohës së provimit, vëzhguesit e sallës nën prezencën e personelit nga ST dhe SM do të mbledhin fletoren me zgjidhjen e testit dhe zarfin e vogël dhe do të futin të dy materialet në një zarf të madh, i cili vuloset (në pjesën që mbyll zarfin) në momentin e mbledhjes së materialeve nga tavolina e kandidatit në prezencë të tij. Gjithashtu do të mbledhen të gjitha testet e provimit.

Në përfundim të testimit, duhet nënshkruar përbri emrit tuaj në listë, përpara se të dilni nga salla.

Kualifikohen fitues kandidatët që fitojnë mbi 50% të pikëve të testit.

**Ju urojmë SUKSESE!**